



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 232/2 Prot.

Gramsh, më 05.02. 2026

V E N D I M

Nr 9 Datë 30/01/2026

Për miratimin e kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Gramsh”** në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit”, midis Bashkisë Gramsh dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 30.01.2026, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë”, bazuar në: Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij; Ligjin Nr.10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar; Ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenet 9 e 11;

VENDOSI

1. Të miratojë lidhjen e kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Elbasan”**, në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit”, për vitin 2026 , midis Bashkisë Gramsh dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.
2. Efektet financiare të zbatimit të kësaj marrëveshje mbulohen nga buxheti i bashkisë i miratuar për vitin 2026 me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.105 datë 29.12.2025.
3. Ngarkohen Kryetari dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Xhulia GJINI

KRYETARI I KËSHILLIT
Enis ZANI

